

20230541041

МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА

Në bazë të nenit 23-b paragrafit 12 të Ligjit për tregti ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 16/04, 128/06, 63/07, 88/08, 159/08, 20/09, 99/09, 105/09, 115/10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 77/21, 215/21, 295/21 dhe 150/22) Ministri i Ekonomisë solli

R R E G U L L O R E **PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E** **FORMULARIT TË KËRKESËS PËR LËSHIMIN E LICENCËS PËR SHITJE TË** **PIJEVE ALKOOLIKE, FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË** **LICENCËS PËR SHITJE TË PIJEVE ALKOOLIKE DHE FORMËN, PËRMBAJTJEN** **DHE MËNYRËN E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË LICENCAVE TË** **LËSHUARA DHE TË REVOKUARA**

Neni 1

Në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për lëshimin e licencës për shitje të pijeve alkoolike, formën dhe përmbajtjen e formularit të licencës për shitje të pijeve alkoolike dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të licencave të lëshuara dhe të revokuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 122/22) Shtojca 2 zëvendësohet me Shtojcën 2 të re që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 11 – 1282/2
8 mars 2023
Shkup

Ministri i Ekonomisë,
Kreshnik Bekteshi, d.v.



Republika e Maqedonisë së veriut

Ministria e ekonomisë

Në bazë të nenit 23-b paragrafi 1 nga Ligji për tregti, Ministria e ekonomisë lëshon:

LICENCË

PËR SHITJE TË PIJEVE ALKOOLIKE

për

(emri i tregtarit me pakicë i cili kryen shitje të pijeve alkoolike)

(selia afariste e tregtarit me pakicë)

(adresa e objektit të shitjes)

Licenca vlen për periudhë dy vjeqare

Nr. Regj. _____

Nr. _____

_____ **viti**

Shkup

V.V.

Personi zyrtar i autorizuar,

Nënshkrimi